



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
"BACHELOR NË GJUHË ANGLEZE"**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit "Bachelor në gjuhë angleze" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të parë, "Bachelor", i cili ofrohet në tre vite akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 180 kredite (ECTs) dhe merr diplomën universitare: "Bachelor në gjuhë angleze". Përveç njërive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për personel administrativ të kualifikuar dhe të pajisur me shprehinë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve me:
 - a. një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, me qëllimin që ata të jenë në gjendje të ndjekin kurse më të përparuara studimi apo të marrin një drejtim në ato fusha ku aftësia për të përdorur gjuhën e huaj me efikasitet dhe ndjeshmëri është thelbësore;
 - b. sigurinë dhe aftësinë për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara, sidomos në fushën e përkthimit, interpretimit, mësimdhënies, komunikimit, për të zhvilluar koncepte shkencore të studimit gjuhësor e letrar;
 - c. baza për studimin e thelluar në ciklin e dytë të studimeve me kahe të posaçme profesionale si: mësues, përkthyes, kritik letrar, etj.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit "Bachelor në gjuhë angleze" organizohet në:
 - a. Lëndë bazë;
 - b. Lëndë karakterizuese;
 - c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
 - d. Lëndë plotësuese;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

- e. Detyrime përmbyllëse.
2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës.
3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar et. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.
4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme:

32 kredite

ALB 148 Gjuhë shqipe	8 kredite
ENG 144 Gjuhë angleze e avancuar 1	8 kredite
ENG 245 Gjuhë angleze e avancuar 2	8 kredite
ENG 346 Gjuhë angleze e avancuar 3	8 kredite

B. LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore:

95 kredite

ENG 356 Gjuhësi e përgjithshme për gjuhën angleze	8 kredite
ENG 151 Gramatikë e gjuhës angleze	8 kredite
<i>Moduli: ENG 151-1 Gramatikë e gjuhës angleze 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 151-2 Gramatikë e gjuhës angleze 2</i>	4 kredite
ENG 193 Fonologji e gjuhës angleze	8 kredite
ENG 241 Semantikë dhe pragmatikë	8 kredite
<i>Moduli: ENG 241-1 Semantikë</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 241-2 Pragmatikë</i>	4 kredite
ENG 255 Hyrje në gjuhësi për gjuhën angleze	8 kredite
ENG 260 Kulturë anglofone	8 kredite
ENG 280 Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën angleze	8 kredite
ENG 282 Letërsi angleze	8 kredite
<i>Moduli: ENG 282-1 Letërsi angleze 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 282-2 Letërsi angleze 2</i>	4 kredite
ENG 381 Letërsi amerikane	8 kredite
<i>Moduli: ENG 381-1 Letërsi amerikane 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 381-2 Letërsi amerikane 2</i>	4 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

ENG 341 Metodatat e mësimdhënies në gjuhën angleze	7 kredite
ENG 170 Arti i të shkruarit për gjuhën angleze	8 kredite
<i>Moduli: ENG 170-1 Arti i të shkruarit</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 170-2 Shkrim akademik</i>	4 kredite
ENG 376 Teknika të përkthimit për gjuhën angleze	8 kredite
<i>Moduli: ENG 376-1 Përkthim</i>	4 kredite
<i>Moduli: ENG 376-2 Interpretim</i>	4 kredite

C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: 26 kredite

ENG 264 Stilistikë 6 kredite

Zgjidh dy nga : 12 kredite (6+6)
ENG 358 Sociolinguistikë për gjuhën angleze/ ENG 265 Histori e gjuhës angleze/
ENG 256 Linguistikë e aplikuar për gjuhën angleze/ ENG 332 Gjuhësi teksti për
gjuhën angleze/ ENG 342 Studime të komunikimit për gjuhën angleze

Zgjidh një nga: 8 kredite (4+4)
ITA 344 Italisht/Frengjisht 344/SPA 344 Spanjisht/GER 344 Gjermanisht (ITA
344-1 Italisht, ITA 344-2 Italisht/FRE 344-1 Frengjisht, FRE 344-2 Frengjisht,
SPA 344-1 Spanjisht, SPA 344-2 Spanjisht/GER 344-1 Gjermanisht, GER 344-2
Gjermanisht)

D. LËNDË PLOTËSUESE –gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: 20 kredite

CS 100 Shkencat kompjuterike 6 kredite

Zgjidh gjuhën: 6 kredite (3+3)

ITA 131 Italisht/Frengjisht 131/SPA 131 Spanjisht/GER 131 Gjermanisht (ITA 131-1 Italisht, ITA
131-2 Italisht/FRE 131-1 Frengjisht, FRE 131-2 Frengjisht, SPA 131-1 Spanjisht, SPA 131-2
Spanjisht/GER 131-1 Gjermanisht, GER 131-2 Gjermanisht)

Zgjidh gjuhën: 8 kredite (4+4)

ITA 132 Italisht/Frengjisht 132/SPA 132 Spanjisht/GER 132 Gjermanisht (ITA 132-1 Italisht, ITA
132-2 Italisht/FRE 132-1 Frengjisht, FRE 132-2 Frengjisht, SPA 132-1 Spanjisht, SPA 132-2
Spanjisht/GER 132-1 Gjermanisht, GER 132-2 Gjermanisht)

E. DETYRIME PËRMBYLLËSE: 7 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

ENG 389 Provim përfundimtar/Punim diplome

7 kredite

Shënim: Moduli konsiderohet i shlyer nëse të gjitha pjesët e tij janë nota kaluese.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredit	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit		Totali orë jashtë auditorit	
							lex	sem		detyra
Viti I	Sem. I	ALB 148	Gjuhë shqipe	8	200	90	3	3	110	
		ENG 144	Gjuhë angleze e avancuar 1	8	200	75	3	2	125	
		ITA 131 (ITA 131-1, ITA 131-2)/FRE 131 (FRE 131-1, FRE 131-2)/SPA 131 (SPA 131-1, SPA 131-2)/GER 131 (GER 131-1, GER 131-2)	Italisht (A1, A2)/Frëngjisht (A1, A2)/Spanjisht (A1, A2)/Gjermanisht (A1, A2)	3+3	150	60	2	2	90	
		ENG 151 (ENG 151-1)	Gramatikë e gjuhës angleze: Moduli: <i>Gramatikë e gjuhës angleze 1</i>	4	100	45	1	2	55	
		ENG 170 (ENG 170-1)	Arti i të shkruarit për gjuhën angleze: Moduli: <i>Arti i të shkruarit</i>	4	100	45	1	2	55	
	TOTALI				30	750	315	10	11	435
	Sem. II	ENG 151 (ENG 151-2)	Moduli: Gramatikë e gjuhës angleze: <i>Gramatikë e gjuhës angleze 2</i>	4	100	45	1	2	55	
		CS 100	Shkenca kompjuterike	6	150	60	2	2	90	
		ENG 170 (ENG 170-2)	Arti i të shkruarit për gjuhën angleze: Moduli: <i>Shkrim akademik</i>	4	100	45	1	2	55	
		ENG 193	Fonologji e gjuhës angleze	8	200	90	3	3	110	
ITA 132 (ITA 132-1, ITA 132-2)/FRE 132 (FRE 132-1, FRE 132-2)/SPA 132 (SPA 132-1, SPA 132-2)/GER 132 (GER 132-1, GER 132-2)		Italisht (B1, B2)/Frëngjisht (B1, B2)/ Spanjisht (B1, B2)/Gjermanisht (B1, B2)	4+4	200	75	3	2	125		
TOTALI				30	750	315	10	11	425	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

	ENG 282 (ENG 282-1)	Letërsi angleze: Moduli: <i>Letërsi angleze 1</i>	4	100	45	1	2	55
	ENG 245	Gjuhë angleze e avancuar 2	8	200	75	3	2	125
	ENG 280	Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	110
	ENG 256/ ENG 265	<i>Zgjidh një nga:</i> Linguistikë e aplikuar për gjuhën angleze/ Histori e gjuhës angleze	6	150	60	2	2	90
	ENG 241 (ENG 241-1)	Semantikë dhe pragmatikë: Moduli: <i>Semantikë</i>	4	100	45	1	2	55
TOTALI			30	750	315	10	11	435
Sem. II	ENG 260	Kulturë anglofone	8	200	90	3	3	110
	ENG 255	Hyrje në gjuhësi për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	110
	ENG 264	Stilistikë për gjuhën angleze	6	150	60	2	2	90
	ENG 282/ENG 282-2	Letërsi angleze: Moduli: <i>Letërsi angleze 2</i>	4	100	45	2	1	55
	ENG 241 (ENG 241-2)	Semantikë dhe pragmatikë: Moduli: <i>Pragmatikë</i>	4	100	45	1	2	55
TOTALI			30	750	330	11	11	400
Viti 3	ENG 346	Gjuhë angleze e avancuar 3	8	200	75	3	2	125
	ENG 381 (ENG 381-1)	Letërsi amerikane: Moduli: <i>Letërsi amerikane 1</i>	4	100	45	2	1	55
	ITA 344 (ITA 344-1, ITA 344-2)/FRE 344 (FRE 344-1, FRE 344-2)/SPA 344 (SPA 344-1, SPA 344-2)/GER 344 (GER 344-1, GER 344-2)	Italisht (A1, A2)/Frengjisht (A1, A2)// Spanjisht (A1, A2)/Gjermanisht (A1, A2)	4+4	200	90	3	3	110
	ENG 332/ ENG 358/ENG 342	<i>Zgjidh një nga:</i> Gjuhësi teksti/Sociolinguistikë për gjuhën angleze/Studime të komunikimit për gjuhën angleze	6	150	60	2	2	90
	ENG 376 (ENG 376-1)	Teknika të përkthimit për gjuhën angleze: Moduli: <i>Përkthim</i>	4	100	45	1	2	45
	TOTALI			30	750	315	11	10
Sem. II	ENG 356	Gjuhësi e përgjithshme për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	120
	ENG 376 (ENG 376-2)	Teknika të përkthimit për gjuhën angleze: Moduli: Interpretim	4	100	45	1	2	45
	ENG 341	Metodat e mësimdhënies në gjuhën angleze	7	175	60	3	1	115
	ENG 381 (ENG 381-2)	Letërsi amerikane: Moduli: <i>Letërsi amerikane 2</i>	4	100	45	1	2	45
	ENG 389	Provim përfundimtar/Punim diplome	7	175	0	0	0	175
TOTALI			30	750	240	8	8	500



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Neni 5

Përshkrimi i disiplineve që ngërthen programi

1. Ky program studimi ngërthen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

a. **ALB 148 Gjuhë shqipe:** *Gjuha shqipe 1, 2* pajis studentët me njohuri nga gramatika. Moduli i parë jep njohuri nga morfologjia si: ç'është fjalëformimi, klasat e fjalëve dhe kategoritë gramatikore.

Zhvillimet e morfologjisë sot dhe mendimi ndryshe në disa gramatika të hartuara.

Moduli (II) si vazhdim i gramatikës pajis studentët me njohuri nga sintaksa: për gjymtyrët e fjalisë, llojet e saj, periudhën dhe ligjëratat.

Vështrimin e mënyrave të bashkimit të fjalëve të gjuhës shqipe sipas kuptimit e natyrës gramatikore, kumtimi i tyre për folësin.

Marrëdhëniet që vendosen midis njësive sintaksore të formuara në ligjërim, për fjalinë e mëvetësishme dhe në përbërje të njësive më të mëdha, bashkimet funksionale që formohen. Teoritë e ndryshme sintaksore dhe mendimet alternativë në gramatika të tjera, evoluimi sot.

b. **ENG 151 (ENG 151-1, ENG 151-2) Gramatikë e gjuhës angleze 1&2:** Qëllimi i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri mbi gramatikën e gjuhës Angleze. Gramatika angleze është lëndë bazë që zhvillohet në departamentin e gjuhëve të huaja (dega anglisht). Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri të nivelit të avancuar të gramatikës angleze dhe t'i aftësojë ata në përdorimin e modeleve e strukturave gramatikore. Gramatika angleze zhvillohet duke bërë një ndërthurje të morfologjisë me sintaksën. Përvetësimi i lëndës bëhet nëpërmjet leksioneve dhe zbatimit praktik të tyre.

c. **ENG 170 (ENG 170-1, ENG 170-2) Arti i të shkruarit:** Kursi *Arti i të shkruarit* është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me të shkruarin në gjuhën angleze, me zhvillim e saktë të eseve dhe anglishten zyrtare, së bashku me shprehitë e sakta për mendimin kritik.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- përvetësojnë subjektin, strukturën e tij, materialet që do të përdoren gjatë procesit mësimor;
- ndërveprojnë me saktësi në përdorimin e gjuhës angleze për zhvillimin e aftësive të tyre me shkrim;
- mendojnë në mënyrë kritike bazuar në literature hulumtuese, përdorimin e thënieve, fjalëve të urta dhe bibliografive;
- krijojnë dhe t'i aftësojë studentët për kompetencat e përfituara gjatë mësimdhënies dhe t'u mundësojë shprehitë e të shkruarit;
- dallojnë përdorimin e saktë të kohëve gramatikore, shenjave të pikësimit dhe korrigjimin e gabimeve ortografike dhe të rrisë kujdesin gjatë përdorimit.

d. **ENG 241 (ENG 241-1, ENG 241-2) Semantikë dhe pragmatikë (Semantikë; Pragmatikë):** Ky kurs ka për qëllim që të paraqesë parimet e semantikës dhe pragmatikës angleze në nivel



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

universitar. Në informacionin që u transmetohet studentëve, një vëmendje e veçantë u jepet mjeteve leksikore dhe gramatikore që përdoren në gjuhën angleze për të shprehur kuptimin në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në kontekst. Në semantikë, kuptimi

- është i lidhur më shumë me fjalët, kurse në pragmatikë më shumë me kontekstin. Janë disa aspekte kuptimore të cilat nuk mund të trajtohen nëse nuk merret parasysh konteksti.

- Studentët do të njihen me trajtimet e ndryshme rreth kuptimit; marrëdhëniet midis fjalëve; llojet e ndryshme të kuptimeve, marrëdhëniet midis fjalive; natyrën e gjuhës; strukturën e ligjërimit; marrëdhëniet që bazohen mbi njësitë e kuptimit si sinonimia, antonimia, hiponimia, ambiguiteti, faktiviteti, aspekti dhe modaliteti ; llojet e kuptimeve që lidhen me njësitë e ndryshme gramatikore, lidhjen midis thënieve dhe kontekstit jashtëgjuhësor, aplikimet praktike të studimit të kuptimit.

- Studentët duhet të kenë ide të qarta rreth Semantikës dhe analizave semantike. Pjesa teorike shoqërohet me fjali të shumta ilustruese të cilat shërbejnë si pikënisje për konceptet dhe përkufizimet e paraqitura. Ushtrimet praktike të kapitujve shërbejnë si nxitje për të marrë pjesë vazhdimisht në zhvillimin e temave, kryesisht duke i drejtuar studentët edhe për të parë ecurinë e tyre në përdorimin e gjuhës angleze. Diskutimet në grup janë mjaft të vlefshme. Gjatë procesit mësimor synohet që studentët :

1. të marrin njohuri në lidhje me parimet bazë të Semantikës.

2. të pajisen me informacion të vlefshëm për të krijuar një pikëpamje logjike në strukturën e ndërlikuar të gjuhës angleze.

3. të jenë në gjendje të bëjnë analizë semantike të fjalive.

4. të kuptojnë rolin e kontekstit në komunikim.

e. **ENG 144 Gjuhë angleze e avancuar 1** është një kurs i nivelit mesatar të anglishtes. Ai synon t'i drejtojë studentët drejt një niveli të avancuar dhe për këtë qëllim mbulon të gjitha aspektet e domosdoshme gjuhësore për këtë stad: gramatikën, fjalorin, leximin dhe shkrimin. Të gjitha aspektet teorike mbështeten nga ushtrime të ndryshme praktike. Provimet e pjesshme, që do të zhvillohen pas çdo pesë mësimesh, synojnë të zbulojnë pikat e dobëta dhe ato të forta të çdo studenti në përvetësimin e gjuhës angleze.

f. **ENG 245 Gjuhë angleze e avancuar 2** është për çdo grup studentësh të cilët janë në procesin e përgatitjes për provimet universitare. Ky kurs përmban një shumëllojshmëri të gjerë aktiviteteve praktike dhe ushtrime të cilat vijnë duke u vështirësuar nga njeri modul te tjetri, derisa në fund, studentët arrijnë detyrat e standardit të provimit. Aktivitetet e ndryshme dhe interesante, ushtrimet rrisin besimin dhe fleksibilitetin e studentëve duke iu mundësuar atyre të zbulojnë se çfarë aspekte të gjuhës angleze duhet të mësojnë ende, në mënyrë që të bëhen përdorues të saktë e të rrjedhshëm të gjuhës angleze. Synohet që nëpërmjet kësaj lënde studentët të zotërojnë aftësitë e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit të gjuhës Angleze, në nivelin Proficiency. Mundësia për të diskutuar, për të komentuar dhe për të gjykuar në mënyrë analitike, përmes teksteve letrare, i inkadron studentët me afër kontekstit kulturor të "target language". Studentët do të jenë të aftë të aplikojnë dhe përvetësojnë njohuritë gramatikore në nivelin e avancuar.

g. **ENG 346 Gjuhë angleze e avancuar 3:** Ky kurs ofron përgatitje dhe rritje të kompetencës gjuhësore të studentëve në të gjitha aftësitë gjuhësore (lexim, shkrim, dëgjim, të folur) dhe synon t'u



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

japë atyre njohuritë e duhura nga ana teorike dhe praktike në të gjitha aftësitë gjuhësore. Ky kurs përkon me nivelin C1 të njohurive gjuhësore, të njohura nga Këshilli Evropian i Gjuhëve.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- Diskutojnë për një numër të madh temash interesante dhe bashkëkohore.
- Zgjerojnë rubrikat dhe teknikat e shkrimit me modele të gatshme që do u shërbejnë atyre për punët që do të krijojnë.
- Pajisen me njohuri më të thelluara gramatikore dhe t'i ilustrojnë ato me ushtrime të tjera që mbulojnë çështjet më thelbësore të gjuhës.

h. ENG 193 Fonologji e gjuhës angleze: Ky kurs teorik vjen me një komponent të fortë praktik. Rëndësi të veçantë i jepet dhënies së njohurisë teorike mbi bazat e fonologjisë, kuptueshmerine e tyre dhe përshkrimin e gjithë sistemit të tingujve (fonologjik) mbi një standard klasik, por edhe mbi një numër të caktuar varietetesh gjuhësore. Të gjitha këto të bazuara mbi standardin zyrtar GA dhe RP.

i. ENG 280 Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën angleze: Kursi është një paraqitje e teorie kryesore letrare që kanë përkufizuar studimet letrare në shekujt e njëzetë dhe të njëzetënjë. Kursi hapet me pyetjet: "Ç'është letërsia? dhe "Ç'është teoria?" duke synuar t'i përkufizojë ato. Në vijim, studentët njihen me teoritë më të diskutuara letrare duke filluar nga teoritë formaliste e duke përfunduar me teoritë pasdmoderne dhe paskoloniale. Qëllimi i kursit nuk është thjesht t'ua paraqesë ato studentëve, por t'i bëjë ata t'i zbatojë ato gjatë leximit të teksteve letrare dhe joletrare si dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

Diskutimi i teorisë të ndryshme letrare, strategjive të ndryshme të leximit dhe interpretimit do të bazohet mbi interpretimin dhe analizën e autorëve të ndryshëm nga periudha dhe tendenca të ndryshme.

j. ENG 282 (ENG 282-2, ENG 282-2) Letërsi Angleze - Kursi synon t'u japë studentëve njohuri të përmbledhura mbi zhvillimet kryesore në Letërsinë Angleze që nga fillimet e saj deri në shekullin e njëzetë e një. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të Letërsisë Angleze duke filluar me letërsinë angleze të vjetër për të vazhduar me letërsinë e mesjetës, rilindjen, iluminizmin, romantizmin, periudhën viktoriane dhe në fund me letërsinë e shkruar në shekullin e njëzetë deri në ditët e sotme. Vëmendje e veçantë i kushtohet periudhave dhe autorëve që kanë lënë gjurmë në letërsinë angleze, si Chaucer-i, Shakespeare-i, Wordsworth-i, Dickens-i, Joyce-i, Beckett-i dhe të tjerë.

Kursi *ENG 282-1 Letërsi Angleze 1* synon t'u japë studentëve njohuri mbi Letërsinë Angleze që nga fillimet e saj deri në periudhën romantike. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të Letërsisë Angleze duke filluar me letërsinë angleze të vjetër për të vazhduar me letërsinë e mesjetës, iluminizmin, romantizmin anglez.

Kursi *ENG 282-2 Letërsi Angleze 2* synon t'u japë studentëve njohuri mbi Letërsinë Angleze që nga periudha viktoriane deri në ditët e sotme. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të këtyre shekujve.

k. ENG 381 (ENG 381-1, ENG 381-1) Letërsi Amerikane: Kursi Letërsi Amerikane synon të japë një panoramë të letërsisë amerikane të shkruar që nga fillimet e saj deri në shekullin e njëzetë dhe në shekullin e njëzetë e një. Kursi, i konceptuar i ndarë në dy pjesë (module), *Letërsi Amerikane 1* dhe *Letërsi Amerikane 2*, është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të letërsisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

amerikane duke filluar me periudhën koloniale për të vazhduar me rilindjen amerikane, tradicionalizmin, natyralizmin, realizmin amerikan, modernizmin dhe pasmodernizmin.

Në këtë kurs studenti do të lexojë për ata autorë si Po, Tuein, Uitman, Shtaini, Hemingueji, Fitsxheraldi, Folkneri, Stevensi, Plathi, Nabokovi, Bellou e të tjerë. Theksi do të vihet tek ndryshimet që përcaktojnë këto periudha në krahasim me periudha të mëparshme apo në krahasim nga njëra-tjetra.

l. **ENG 255 Hyrje në gjuhësi:** Kursi i këtij semestri paqaret bazat e analizës gjuhësore: cfarë gjuhëtarët thonë për tingujt e gjuhëve, si dhe strukturën e fjalive dhe fjalëve individuale. Studentët do të prezantohen me parimet gjuhësore dhe do të kuptojnë më shumë për mënyrën se si funksionojnë gjuhët. Ne gjithashtu shikojmë në studimin e kuptimit.

m. **ENG 260 Kulturë anglofone:** Kursi *Kulturë anglofone* ka për qëllim të njohi studentët me zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe qytetërimit të vendeve anglofone ndër vite. Ky kurs është i konceptuar në dy pjesë:

1. Kultura e Mbretërisë së bashkuar dhe Irlandës përgjatë shekujve dhe zhvillimet e shekullit të 21.

- Historia dhe gjurmët kulturore
- Shoqëria bashkëkohore dhe vlerat
- Zakonet dhe traditat
- Familja
- Qeverisja
- Edukimi
- Media
- Arti
- Sporti
- Besimi

2. Kultura e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përgjatë shekujve dhe zhvillimet e shekullit të 21.

- Historia dhe gjurmët kulturore
- Shoqëria bashkëkohore dhe vlerat
- Zakonet dhe traditat
- Familja
- Qeverisja
- Edukimi
- Media
- Arti
- Sporti
- Besimi

n. **ENG 342 Studime të komunikimit në gjuhën angleze** është një kurs i projektuar për studentët e gjuhës angleze që të zhvillojnë njohuritë e mëtejshme dhe të kuptojnë teorinë e komunikimit nderaktiv. Ky kurs shqyrton koncepte teorike në kontekste relevante të studimit të komunikimit human. Përveç teorisë gërshetohen dhe studimet e rastit në praktikë në formën e vizitave , workshope, pjesmarrje në konferenca apo leksione të hapura në universitete të ndryshme në Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

si dhe takime me organizata joqeveritare, për të krijuar njohuri me të qarta për faktorë dhe medie të ndryshme komunikimi. Në fund të semestrit studentët do të kenë përmbushur objektivat e mëposhtme: Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- përvetësojnë kompetencat e komunikimit ndërkulturor.
- ndërveprojnë me sukses në situata të ndryshme me interlokutorë që u përkasin sfoneve të tjera e të ndryshme kulturore e gjuhësore.
- mendojnë në mënyrë kritike për situata të ndryshme kulturore e të gjykojnë sesi do të vepronin në rast përplasjesh kulturore.
- krijojnë një sens qytetarie globale.
- dallojnë stilet dhe mënyrat e ndryshme të komunikimit në një kontekst ndërkulturor.

o. ENG 358 Sociolinguistikë e gjuhës angleze: Në këtë kurs, sociolinguistika mësohet si një degë e gjuhësisë që studion gjuhën në raport me shoqërinë. Objektivi kryesor i sociolinguistikës është të shpjegojë se si variacionet linguistike të folësve (p.sh. sjelljet e tyre të ndryshueshme gjuhësore) janë të lidhura me variacionin në karakteristikat sociale të folësve (dmth prejardhja e tyre sociale).

Qëllimi i studimit të sociolinguistikës është për të arritur një përparim të mëtijshëm në njohjen e natyrës dhe funksionin e gjuhës njerëzore nga ana e studimit të gjuhës në kontekstin e saj social. Variant i saj është rezultat i faktorëve të ndryshëm si: feja, moshja, përkatësia etnike, gjinia, etj. Ajo tregon se kombinimi i këtyre komponentëve mbart ndikim në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës.

p. ENG 332 Gjuhësi teksti për gjuhën angleze: Kursi *Gjuhësi teksti* është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen teori dhe metodologji për studimin e diskursit njerëzor, ose gjuhës në përdorim. Historiku i diskursit, supozimet dhe parimet, komunikimi verbal dhe joverbal, si dhe roli i shoqërisë dhe kulturës do të merren në shqyrtim. Do të diskutohet si diskursi i folur, ashtu edhe ai i shkruar.

q. ENG 376 (ENG 376-1, ENG 372-2) Teknika të përkthimit për gjuhën angleze: Ky kurs do të prezantojë një numër çështjesh që duhen marrë në konsideratë kur kryejmë përkthimin nga njëra gjuhë në tjetrën.(përkthimi ndërgjuhësor). Ai do të trajtojë çfarë pritet nga një përkthim i mirë dhe do të vazhdojë debatin e vazhdueshëm se sa i lirë apo besnik ndaj origjinalit duhet të jetë përkthimi në gjuhën e synuar. Ky kurs do të trajtojë tipet e teksteve, lexuesin, qëllimin dhe çështjet kulturore në përkthim. Ai do të mbështetet në teorinë e gjuhësisë moderne për të trajtuar koncepte si p.sh ekuivalenca, qoftë në nivelin e fjalës apo përtej saj, kompesimin, probleme që lidhen me përkthimin e regjistrave të gjuhës, sociolektin dhe dialektin. Leksionet dhe pjesët për lexim do t'i drejtojnë studentët tek çështjet teorike, ndërsa seminarët do të fokusohen në analizën dhe përkthimin e teksteve nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas. Kjo do t'i ndihmojë studentët për zhvillimin e aftësive të tyre në identifikimin e problemeve dhe vlerësimin e zgjidhjeve, duke u mbështetur në teorinë dhe teknikat e përkthimit, si dhe do t'i inkurajojnë ata për t'i përdorur këto aftësi në praktikë. Në të njëjtën kohë, duke analizuar dhe përkthyer tekste të ndryshme studentët do të kenë rastin të zhvillojnë dhe praktikojnë edhe kritikën e përkthimit, redaktimin dhe vlerësimin e teksteve të botuara të zhanreve të ndryshme.

r.ENG 265 Histori e gjuhës angleze: Në këtë kurs do të shqyrtojmë faktorët gjuhësorë, historikë dhe kulturorë që kanë ndikuar në zhvillimin e gjuhës angleze. Do të fillojmë duke parë idetë nga gjuhësia historike që lejojnë gjuhëtarët të rindërtojnë gjuhët, duke përfshirë edhe gjuhët indo-evropiane nga të cilat u rrit anglishtja. Më pas do të kalojmë nëpër secilën nga periudhat kryesore të zhvillimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

gjuhës angleze, nga anglishtja e vjetër në anglishten e mesme dhe pastaj në anglishten moderne. Së fundi, do të shqyrtojmë anglishten e sotme, përfshirë dialektet në Britani, Shtetet e Bashkuara dhe përhapjen globale të varieteteve angleze anembanë botës. Kursi do të theksojë natyrën fluide dhe dinamike të ndryshimit të gjuhës duke u fokusuar në mënyrën sesi struktura e gjuhës është e lidhur ngushtë me kontekstin socio-historik, duke kombinuar historinë e brendshme gjuhësore dhe historinë e jashtme kulturore.

s. **ENG 256 Linguistikë e aplikuar për gjuhën angleze:** Kursi *Linguistikë e aplikuar* është një kurs hyrës, i cili synon t'i pajisë studentët që ndjekin këtë program studimi me njohuri të përmbledhura rreth bazave teorike të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës, të kuptuarit të gjuhës si sistem, në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të marrin njohuri të vlefshme rreth kësaj fushe tejet përfshirëse, por edhe t'i kuptojnë dhe zbatojnë këto njohuri gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

t. **ENG 264 Stilistikë:** Gjatë këtij kursi studentët do të njihen me konceptet bazë të Stilistikës dhe zhvillimet e rëndësishme kërkimore në këtë fushë. Kjo lëndë ofron një paraqitje të metodave dhe teorive stilistikore që ndihmojnë në zbulimin e shtresave, modeleve dhe niveleve që përbëjnë përshkrimin stilistikor për lloje të ndryshme tekstesh.

Elementi i stilit dhe analizat stilistikore do të shqyrtohen të lidhura ngushtë me nivele të ndryshme të gjuhës si: nivelin fonetik, gramatikor, sintaksor, semantik dhe pragmatik. Studentët do të diskutojnë, analizojnë dhe do të vendosin në praktikë metodat dhe modelet e analizës së tekstit. Ata do të jenë në gjendje të gjejnë shenjuesit stilistikorë të tekstit letrar, ligjor, politik, gazetaresk si dhe reklamave.

u. **CS 100 Shkenca kompjuterike:** Temat e trajtuara në lëndën "Shkenca kompjuterike" sigurojnë një formim të përgjithshëm për bazat e informatikës.

Në temat e trajtuara theksohet rëndësia e kompjuterit dhe informatikës në aspektin praktik. Studimi i pjeseve kompjuterike, i programeve bazë të paketës Microsoft Office, sistemet numerike, interneti, shërben për të njohur në vija të përgjithshme bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Kjo lëndë i njeh studentët me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si një element i domosdoshëm për funksionimin dhe suksesin e një institucioni në një shoqëri të drejtuar nga teknologjia. Studentet do të pajisen me njohuritë baze në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, duke përfituar kompetenca në përpunimin e dokumenteve, përpunimin e tabelave në excel, zhvillim dhe përdorim i bazave të të dhënave, faqesje dhe prezantim i informacionit.

v. **ITA 131 (131-1; 131-2) Italisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

w. **FRE 131 (131-1; 131-2) Frëngjisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

x. **SPA 131 (131-1; 131-2) Spanjisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

y. **GER 131 (131-1; 131-2) Gjermanisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

z. **ITA 132 (132-1; 132-2) Italisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit B2.

aa. **FRE 132 (132-2; 132-2) Frëngjisht:** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF B2 sipas Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

bb. **GER 132 (132-1; 132-2) Gjermanisht:** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës gjermane, në dy module, dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin B2 sipas Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën gjermane. Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

cc. **SPA 132 (132-1; 132-2) Spanjisht:** Kursi *Spanjisht 2* ka si synim ta pajisë studentin me njohuri të gjuhës spanjolle të folur dhe të shkruar si një gjuhë ndërkombëtare. Ky kurs përmban 12 kapituj, secili prej të cilëve përfshin këto rubrika:

- Përmbajtjen funksionale
- Përmbajtjen gramatikore
- Tekste dhe leksik
- Komponentin strategjik (për zhvillimin e të kuptuarit tekstual)
- Përmbajtjen kulturore
- Fonetikë/ortografi

Kursi parashikohet për studentët të cilët kanë disa njohuri paraprake në gjuhën spanjolle dhe dëshirojnë t'i përparojnë ato në nivelin B2.

dd. **ITA 344:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimin të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1-A2.

ee. **FRE 344:** Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF C1 sipas Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit. Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1-A2.

ff. **GER 344:** Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit. Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1-A2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

gg. **SPA 344:** Kursi 'Spanjisht 344' ka si synim ta pajisë studentin me njohuri të gjuhës spanjolle të folur dhe të shkruar si një gjuhë ndërkombëtare. Ky kurs përmban 12 kapituj, secili prej të cilëve përfshin këto rubrika:

- Përmbajtjen funksionale
- Përmbajtjen gramatikore
- Tekste dhe leksik
- Komponentin strategjik (për zhvillimin e të kuptuarit tekstual)
- Përmbajtjen kulturore
- Fonetikë/ortografi

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1-A2.

hh. **ENG 389 Provim përfundimtar:** Provimi i përgjithshëm i formimit është një provim përmbyllës që jepet nga studenti vetëm pasi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tjera akademike për plotësimin e programit të studimit. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor (C1), kulturor dhe ndërkulturor të studentit përmes ushtrimeve të larmishme për të shquar aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve të marra së bashkë. Provimi me shkrim do të zërë 40% të vlerësimit, kurse provimi me gojë 60 %.

Neni 6

Format dhe organizimi i studimit të programit "Bachelor në gjuhë angleze"

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare,) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj).

Neni 7

Format e kontrollit të dijeve

1. Programi mësimor "Bachelor në gjuhë angleze" parashikon provime të pjesshme, vlerësime vjetore, provime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.
2. Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit.
3. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, esetë, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomave.
4. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).
5. Kontrolli i dijeve së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

- a) me shkrim,
 - b) me gojë,
 - c) i kombinuar, me shkrim e me gojë,
- duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.
6. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 8

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
2. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).
3. Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo *syllabus*, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.
4. Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 9

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

1. Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:
 - a. Kontrolli i njohurive bëhet thjesht me një provim final, ose me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.
 - b. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
2. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
3. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

4. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
5. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
6. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 10

Orari i studimit dhe provimeve

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimin përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimmindhënsit.
2. Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.
3. Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 11

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 12

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

1. Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: ese ose kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster.
2. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 13

Vlerësimi për diplomim

1. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome.
2. Studenti mesatarja e përgjithshme e të cilit është 9.0 (vlerësimet e marra në semestrin e parë), i njihet e drejta të realizojë punim diplome.
3. Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:
 - a. Të jenë studime individuale,
 - b. Të jenë studime deskriptive apo analitike.
 - c. Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

- d. Të ndjekin rregullat e shpallura nga DGJH për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016, si dhe Rregulloren e punimeve të miratuar nga DGJH (shtojca bashkëlidhur).
4. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor të studentit (C1) përmes ushtrimeve gjuhësore (gramatikore dhe leksikore), si dhe njohuritë kulturore e aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

Neni 14

Modalitetet për dhënien e diplomës

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve në programin "Bachelor në gjuhë angleze" janë:
- a. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disipinat:
- e formimit bazë (2)
 - karakterizues (6)
 - ndërdisiplinore/integruese (4)
 - plotësuese (2)
- b. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në provimin e formimit/punimin e diplomës.
- c. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 180 ECTS (kredite).
- d. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studentin paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DGJH-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 15

Shkeljet e integritetit akademik

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:
- a. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
- b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjëzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifraximeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifraximet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

d. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterike të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 16

Dispozita të veçanta

1. Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos për sa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
"BACHELOR NË GJUHË ITALIANE"**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit "Bachelor në gjuhë italiane" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të parë, "Bachelor", i cili ofrohet në tre vite akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 180 kredite (ECTs) dhe merr diplomën universitare: "Bachelor në gjuhë italiane". Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për personel administrativ të kualifikuar dhe të pajisur me shprehinë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve me:

- një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, me qëllimin që ata të jenë në gjendje të ndjekin kurse më të përparuara studimi apo të marrin një drejtim në ato fusha ku aftësia për të përdorur gjuhën e huaj me efikasitet dhe ndjeshmëri është thelbësore;
- sigurinë dhe aftësinë për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara, sidomos në fushën e përkthimit, interpretimit, mësimdhënies, komunikimit, për të zhvilluar koncepte shkencore të studimit gjuhësor e letrar;
- baza për studimin e thelluar në ciklin e dytë të studimeve me kahe të posaçme profesionale si: mësuës, përkthyes, kritik letrar, etj.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit "Bachelor në gjuhë italiane" organizohet në:

- Lëndë bazë;
- Lëndë karakterizuese;
- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
- Lëndë plotësuese;
- Detyrime përmbyllëse.

2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës.

3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar et. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme:

32 kredite

ALB 148 Gjuhë shqipe	8 kredite
ITA 144 Gjuhë italiane e avancuar 1	8 kredite
ITA 245 Gjuhë italiane e avancuar 2	8 kredite
ITA 346 Gjuhë italiane e avancuar 3	8 kredite

B. LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore:

95 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

ITA 356 Gjuhësi e përgjithshme për gjuhën italiane	8 kredite
ITA 151 Gramatikë e gjuhës italiane	8 kredite
<i>Moduli: ITA 151-1 Gramatikë e gjuhës italiane 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 151-2 Gramatikë e gjuhës italiane 2</i>	4 kredite
ITA 193 Fonologji e gjuhës italiane	8 kredite
ITA 241 Semantikë dhe pragmatikë	8 kredite
<i>Moduli: ITA 241-1 Semantikë</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 241-2 Pragmatikë</i>	4 kredite
ITA 255 Hyrje në gjuhësi për gjuhën italiane	8 kredite
ITA 260 Kulturë italiane	8 kredite
ITA 280 Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën italiane	8 kredite
ITA 282 Letërsi italiane	8 kredite
<i>Moduli: ITA 282-1 Letërsi italiane 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 282-2 Letërsi italiane 2</i>	4 kredite
ITA 381 Letërsi italiane	8 kredite
<i>Moduli: ITA 381-1 Letërsi italiane 1</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 381-2 Letërsi italiane 2</i>	4 kredite
ITA 341 Metodot e mësimdhënies në gjuhën italiane	7 kredite
ITA 170 Arti i të shkruarit për gjuhën italiane	8 kredite
<i>Moduli: ITA 170-1 Arti i të shkruarit</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 170-2 Shkrim akademik</i>	4 kredite
ITA 376 Teknika të përkthimit për gjuhën italiane	8 kredite
<i>Moduli: ITA 376-1 Përkthim</i>	4 kredite
<i>Moduli: ITA 376-2 Interpretim</i>	4 kredite

C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: 26 kredite

Zgjidh dy nga : 12 kredite (6+6)
ITA 358 Sociolinguistikë për gjuhën italiane/ ITA 265 Histori e gjuhës italiane/
ITA 256 Linguistikë e aplikuar për gjuhën italiane/ ITA 332 Gjuhësi teksti për gjuhën italiane/ ITA 342 Studime të komunikimit për gjuhën italiane

Zgjidh një nga: 8 kredite (4+4)
ENG 344 Anglisht/Frengjisht 344/SPA 344 Spanjisht/GER 344 Gjermanisht
(ENG 344-1 Anglisht, ENG 344-2 Anglisht/FRE 344-1 Frengjisht, FRE 344-2 Frengjisht, SPA 344-1 Spanjisht, SPA 344-2 Spanjisht/GER 344-1 Gjermanisht, GER 344-2 Gjermanisht)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

D. LËNDË PLOTËSUESE –gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale: 20 kredite

CS 100 Shkencat kompjuterike 6 kredite

Zgjidh gjuhën: 6 kredite (3+3)

ENG 131 Anglisht/Frengjisht 131/SPA 131 Spanjisht/GER 131 Gjermanisht (ENG 131-1 Anglisht, ENG 131-2 Anglisht/FRE 131-1 Frengjisht, FRE 131-2 Frengjisht, SPA 131-1 Spanjisht, SPA 131-2 Spanjisht/GER 131-1 Gjermanisht, GER 131-2 Gjermanisht)

Zgjidh gjuhën: 8 kredite (4+4)

ENG 132 Anglisht/Frengjisht 132/SPA 131 Spanjisht/GER 132 Gjermanisht (ENG 132-1 Anglisht, ENG 132-2 Anglisht/FRE 132-1 Frengjisht, FRE 132-2 Frengjisht, SPA 132-1 Spanjisht, SPA 132-2 Spanjisht/GER 132-1 Gjermanisht, GER 132-2 Gjermanisht)

E. DETYRIME PËRMBYLLËSE: 7 kredite

ITA 389 Provim përfundimtar/Punim diplome 7 kredite

Shënim: Moduli konsiderohet i shlyer nëse të gjitha pjesët e tij janë nota kaluese.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredi	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit		Totali orë jashtë auditorit
							lex	sem	
Viti I	Sem. I	ALB 148	Gjuhë shqipe	8	200	90	3	3	110
		ITA 144	Gjuhë italiane e avancuar I	8	200	75	3	2	125
		ENG 131 (ENG 131-1, ENG 131-2/FRE 131 (FRE 131-1, FRE 131-2)/SPA 131 (SPA 131-1, SPA 131-2)/GER 131 (GER 131-1, GER	Anglisht (A1, A2)/Frëngjisht (A1, A2)/Spanjisht (A1, A2)/Gjermanisht (A1, A2)	3+3	150	60	2	2	90



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

	131-2)								
	ITA 151 (ITA 151-1)	Gramatikë e gjuhës italiane: Moduli: <i>Gramatikë e gjuhës italiane 1</i>	4	100	45	1	2	55	
	ITA 170 (ITA 170-1)	Arti i të shkruarit për gjuhën italiane: Moduli: <i>Arti i të shkruarit</i>	4	100	45	1	2	55	
	TOTALI		30	750	315	10	11	435	
Sem. II	ITA151 (ITA 151-2)	Moduli: Gramatikë e gjuhës italiane: <i>Gramatikë e gjuhës italiane 2</i>	4	100	45	1	2	55	
	CS 100	Shkenca kompjuterike	6	150	60	2	2	90	
	ITA 170 (ITA 170-2)	Arti i të shkruarit për gjuhën italiane: Moduli: <i>Shkrim akademik</i>	4	100	45	1	2	55	
	ITA193	Fonologji e gjuhës italiane	8	200	90	3	3	110	
	ENG 132 (ENG 132-1, ENG 132-2)/FRE 132 (FRE 132-1, FRE 132-2)/SPA 132 (SPA 132-1, SPA 132-2)/GER 132 (GER 132-1, GER 132-2)	Anglisht (B1, B2)/Frengjisht (B1, B2)/Spanjisht (B1, B2)/Gjermanisht (B1, B2)	4+4	200	75	3	2	125	
	TOTALI		30	750	315	10	11	425	
Sem. II	ITA 282 (ITA 282-1)	Letërsi italiane: Moduli: <i>Letërsi italiane 1</i>	4	100	45	1	2	55	
	ITA 245	Gjuhë italiane e avancuar 2	8	200	75	3	2	125	
	ITA 280	Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën italiane	8	200	90	3	3	110	
	ITA 256/ ITA 265	<i>Zgjidh një nga:</i> Linguistikë e aplikuar për gjuhën italiane/ Histori e gjuhës italiane	6	150	60	2	2	90	
	ITA 241 (ITA 241-1)	Semantikë dhe pragmatikë: Moduli: <i>Semantikë</i>	4	100	45	1	2	55	
	TOTALI		30	750	315	10	11	435	
Sem. II	ITA 260	Kulturë italiane	8	200	90	3	3	110	
	ITA 255	Hyrje në gjuhësi për gjuhën italiane	8	200	90	3	3	110	
	ITA 264	Stilistikë për gjuhën italiane	6	150	60	2	2	90	
	ITA 282/ITA 282-2	Letërsi angleze: Moduli: <i>Letërsi italiane 2</i>	4	100	45	2	1	55	
	ITA 241 (ITA 241-2)	Semantikë dhe pragmatikë: Moduli: <i>Pragmatikë</i>	4	100	45	1	2	55	
	TOTALI		30	750	330	11	11	400	
Viti 3 Sem. I	ITA 346	Gjuhë angleze e avancuar 3	8	200	75	3	2	125	
	ITA 381 (ITA 381-1)	Letërsi italiane: Moduli: <i>Letërsi italiane 1</i>	4	100	45	2	1	55	
	ENG 344 (ITA 344-1, ENG 344-2)/FRE 344 (FRE 344-1, FRE 344-2)/SPA 344	Anglisht (A1, A2)/Frengjisht (A1, A2)// Spanjisht (A1, A2)/Gjermanisht (A1, A2)	4+4	200	90	3	3	110	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	(SPA 344-1, SPA 344-2)/GER 344 (GER 344-1, GER 344-2)							
	ITA 332/ ITA 358/ITA 342	Zgjidh një nga: Gjuhësi teksti/Sociolinguistikë për gjuhën italiane/Studime të komunikimit për gjuhën italiane	6	150	60	2	2	90
	ITA 376 (ITA 376-1)	Teknika të përkthimit për gjuhën italiane: Moduli: <i>Përkthim</i>	4	100	45	1	2	45
TOTALI			30	750	315	11	10	425
Sem. II	ITA 356	Gjuhësi e përgjithshme për gjuhën italiane	8	200	90	3	3	120
	ITA 376 (ITA 376-2)	Teknika të përkthimit për gjuhën italiane: Moduli: Interpretim	4	100	45	1	2	45
	ITA 341	Metodat e mësimdhënies në gjuhën italiane	7	175	60	3	1	115
	ITA 381 (ITA 381-2)	Letërsi italiane: Moduli: <i>Letërsi italiane 2</i>	4	100	45	1	2	45
	ITA 389	Provim përfundimtar/Punim diplome	7	175	0	0	0	175
TOTALI			30	750	240	8	8	500

Neni 5

Përshkrimi i disiplineve që ndërthen programi

1. Ky program studimi ndërthen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

a. **ALB 148 Gjuhë shqipe:** *Gjuha shqipe 1, 2* pajis studentët me njohuri nga gramatika. Moduli i parë jep njohuri nga morfologjia si: ç'është fjalëformimi, klasat e fjalëve dhe kategoritë gramatikore.

Zhvillimet e morfologjisë sot dhe mendimi ndryshe në disa gramatika të hartuara.

Moduli (II) si vazhdim i gramatikës pajis studentët me njohuri nga sintaksa: për gjymtyrët e fjalisë, llojet e saj, periudhën dhe ligjëratat.

Vështrimin e mënyrave të bashkimit të fjalëve të gjuhës shqipe sipas kuptimit e natyrës gramatikore, kumtimi i tyre për folësin.

Marrëdhëniet që vendosen midis njësive sintaksore të formuara në ligjërim, për fjalinë e mëvetësishme dhe në përbërje të njësive më të mëdha, bashkimet funksionale që formohen. Teoritë e ndryshme sintaksore dhe mendimet alternativë në gramatika të tjera, evoluimi sot.

b. **ITA 151 (ITA 151-1, ITA 151-2) Gramatikë e gjuhës italiane 1&2:** Qëllimi i këtij programi është të pajisë studentët me njohuri mbi gramatikën e gjuhës italiane. Gramatika italiane është lëndë bazë që zhvillohet në departamentin e gjuhëve të huaja (dega italisht). Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri të nivelit të avancuar të gramatikës italiane dhe t'i aftësojë ata në përdorimin e modeleve e strukturave gramatikore. Gramatika italiane zhvillohet duke bërë një ndërthurje të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

morfologjisë me sintaksën. Përvetësimi i lëndës bëhet nëpërmjet leksioneve dhe zbatimit praktik të tyre.

c. **ITA 170 (ITA 170-1, ITA 170-2) Arti i të shkruarit:** Kursi *Arti i të shkruarit* është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me të shkruarin në gjuhën italiane, me zhvillim e saktë të eseve dhe anglishten zyrtare, sëbashku me shprehitë e sakta për mendimin kritik.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- a. përvetësojnë subjektin, strukturën e tij, materialet që do të përdoren gjatë procesit mësimor;
 - b. ndërveprojnë me saktësinë përdorimin e gjuhës italiane për zhvillimin e aftësive të tyre me shkrim;
 - c. mendojnë në mënyrë kritike bazuar në literature hulumtuese, përdorimin e thënieve, fjalëve të urta dhe bibliografive;
 - d. krijojnë dhe t'i aftësojë studentët për kompetencat e përfituara gjatë mësimdhënies dhe t'u mundësojë shprehitë e të shkruarit;
 - e. dallojnë përdorimin e saktë të kohëve gramatikore, shenjave të pikësimit dhe korrigjimin e gabimeve ortografike dhe të rrisë kujdesin gjatë përdorimit.
- d. **ITA 241 (ITA 241-1, ITA 241-2) Semantikë dhe pragmatikë (Semantikë; Pragmatikë):** Ky kurs ka për qëllim që të paraqesë parimet e semantikës dhe pragmatikës italiane në nivel universitar. Në informacionin që u transmetohet studentëve, një vëmendje e veçantë u jepet mjeteve leksikore dhe gramatikore që përdoren në gjuhën angleze për të shprehur kuptimin në përgjithësi dhe në mënyrë të vecantë në kontekst. Në semantikë, kuptimi është i lidhur më shumë me fjalët, kurse në pragmatikë më shumë me kontekstin. Janë disa aspekte kuptimore të cilat nuk mund të trajtohen nëse nuk merret parasysh konteksti. Studentët do të njihen me trajtimet e ndryshme rreth kuptimit; marrëdhëniet midis fjalëve; llojet e ndryshme të kuptimeve, marrëdhëniet midis fjalive; natyrën e gjuhës; strukturën e ligjërimit; marrëdhëniet që bazohen mbi njësitë e kuptimit si sinonimia, antonimia, hiponimia, ambiguiteti, faktiviteti, aspekti dhe modaliteti; llojet e kuptimeve që lidhen me njësitë e ndryshme gramatikore, lidhjen midis thënieve dhe kontekstit jashtëgjuhësor, aplikimet praktike të studimit të kuptimit. Studentët duhet të kenë ide të qarta rreth Semantikës dhe analizave semantike. Pjesa teorike shoqërohet me fjali të shumta ilustruese të cilat shërbejnë si pikënisje për konceptet dhe përkufizimet e paraqitura. Ushtrimet praktike të kapitujve shërbejnë si nxitje për të marrë pjesë vazhdimisht në zhvillimin e temave, kryesisht duke i drejtuar studentët edhe për të parë ecurinë e tyre në përdorimin e gjuhës italiane. Diskutimet në grup janë mjaft të vlefshme. Gjatë procesit mësimor synohet që studentët:
1. të marrin njohuri në lidhje me parimet bazë të Semantikës.
 2. të pajisen me informacion të vlefshëm për të krijuar një pikëpamje logjike në strukturën e ndërlikuar të gjuhës italiane.
 3. të jenë në gjendje të bëjnë analizë semantike të fjalive.
 4. të kuptojnë rolin e kontekstit në komunikim.
- e. **ITA 144 Gjuhë italiane e avancuar 1** është një kurs i nivelit mesatar të italishtes. Ai synon t'i drejtojë studentët drejt një niveli të avancuar dhe për këtë qëllim mbuon të gjitha aspektet e domosdoshme gjuhësore për këtë stad: gramatikën, fjalorin, leximin dhe shkrimin. Të gjitha aspektet teorike mbështeten nga ushtrime të ndryshme praktike. Provimet e pjesshme, që do të zhvillohen pas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

çdo pesë mësimesh, synojnë të zbulojnë pikat e dobëta dhe ato të forta të çdo studenti në përvetësimin e gjuhës italiane.

f. **ITA 245 Gjuhë italiane e avancuar 2** është për çdo grup studentësh të cilët janë në procesin e përgatitjes për provimet universitare. Ky kurs përmban një shumëllojshmëri të gjerë aktiviteteve praktike dhe ushtrime të cilat vijnë duke u vështirësuar nga njeri modul te tjetri, derisa në fund, studentët arrijnë detyrat e standardit të provimit. Aktivitetet e ndryshme dhe interesante, ushtrimet rrisin besimin dhe fleksibilitetin e studentëve duke iu mundësuar atyre të zbulojnë se çfarë aspekte të gjuhës italiane duhet të mësojnë ende, në mënyrë që të bëhen përdorues të saktë e të rrjedhshëm të gjuhës italiane. Synohet që nëpërmjet kësaj lënde studentët të zotërojnë aftësitë e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit të gjuhës italiane. Mundësia për të diskutuar, për të komentuar dhe për të gjykuar në mënyrë analitike, përmes teksteve letrare, i inkuadron studentët me afër kontekstit kulturor të "target language". Studentët do të jenë të aftë të aplikojnë dhe përvetësojnë njohuritë gramatikore në nivelin e avancuar.

g. **ITA 346 Gjuhë italiane e avancuar 3:** Ky kurs ofron përgatitje dhe rritje të kompetencës gjuhësore të studentëve në të gjitha aftësitë gjuhësore (lexim, shkrim, dëgjim, të folur) dhe synon t'u japë atyre njohuritë e duhura nga ana teorike dhe praktike në të gjitha aftësitë gjuhësore. Ky kurs përkon me nivelin C1 të njohurive gjuhësore, të njohura nga Këshilli Evropian i Gjuhëve.

Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- Diskutojnë për një numër të madh temash interesante dhe bashkëkohore.
- Zgjerojnë rubrikat dhe teknikat e shkrimit me modele të gatshme që do u shërbejnë atyre për punët që do të krijojnë.
- Pajisen me njohuri më të thelluara gramatikore dhe t'i ilustrojnë ato me ushtrime të tjera që mbulojnë çështjet më thelbësore të gjuhës.

h. **ITA 193 Fonologji e gjuhës italiane:** Ky kurs teorik vjen me një komponent të fortë praktik. Rëndësi të veçantë i jepet dhënies së njohurisë teorike mbi bazat e fonologjisë, kuptueshmerine e tyre dhe përshkrimin e gjithë sistemit të tingujve (fonologjik) mbi një standard klasik, por edhe mbi një numër të caktuar varietetesh gjuhësore. Të gjitha këto të bazuara mbi standardin zyrtar GA dhe RP.

i. **ITA 280 Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën italiane:** Kursi është një paraqitje e teorive kryesore letrare që kanë përkufizuar studimet letrare në shekujt e njëzetë dhe të njëzetënjë. Kursi hapet me pyetjet: "Ç'është letërsia?" dhe "Ç'është teoria?" duke synuar t'i përkufizojë ato. Në vijim, studentët njihen me teoritë më të diskutuara letrare duke filluar nga teoritë formaliste e duke përfunduar me teoritë pasdmoderne. Qëllimi i kursit nuk është thjesht t'ua paraqesë ato studentëve, por t'i bëjë ata t'i zbatojnë ato gjatë leximit të teksteve letrare dhe joletrare si dhe të zhvillojnë mendimin kritik. Diskutimi i teorive të ndryshme letrare, strategjive të ndryshme të leximit dhe interpretimit do të bazohet mbi interpretimin dhe analizën e autorëve të ndryshëm nga periudha dhe tendenca të ndryshme.

j. **ITA 282 (ITA 282-2, ITA 282-2) Letërsi italiane 1, 2** - Kursi synon t'u japë studentëve njohuri të përmbledhura mbi zhvillimet kryesore në Letërsinë italiane që nga fillimet e saj deri në shekullin e njëzet e një. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të Letërsisë italiane duke filluar me letërsinë italiane të vjetër për të vazhduar me letërsinë e mesjetës, rilindjen, iluminizmin, romantizmin, dhe në fund me letërsisë e shkruar në shekullin e njëzet deri në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

ditët e sotme. Vëmendje e veçantë i kushtohet periudhave dhe autorëve që kanë lënë gjurmë në letërsinë italiane, si Dante-ja, Petrarca, Boccaccio-ja, Pirandello-ja, Carducci-i, Camiller-i dhe të tjerë. Kursi *ITA 282-1 Letërsi italiane 1* synon t'u japë studentëve njohuri mbi Letërsinë italiane që nga fillimet e saj deri në periudhën romantike. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të Letërsisë italiane duke filluar me letërsinë italiane të vjetër për të vazhduar me letërsinë e mesjetës, iluminizmin, romantizmin italian.

Kursi *ITA282-2 Letërsi italiane 2* synon t'u japë studentëve njohuri mbi Letërsinë italiane që nga periudha e Dantes deri në ditët e sotme. Kursi është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të këtyre shekujve.

k. **ITA 381 (ITA 381-1, ITA 381-1) Letërsi italiane:** Kursi Letërsi italiane synon të japë një panoramë të letërsisë italiane të shkruar që nga fillimet e saj deri në shekullin e njëzetë dhe në shekullin e njëzet e një. Kursi, i konceptuar i ndarë në dy pjesë (module), *Letërsi italiane 1* dhe *Letërsi italiane 2*, është një pasqyrim kronologjik i periudhave më të rëndësishme të letërsisë italiane duke filluar me periudhën e Dantes për të vazhduar me rilindjen italiane, tradicionalizmin, natyralizmin, realizmin italian, modernizmin dhe pasmodernizmin.

Në këtë kurs studenti do të lexojë për ata autorë si Dante-ja, Petrarca, Boccaccio-ja, Pirandello-ja, Carducci-i, Camiller-i dhe të tjerë. Theksi do të vihet tek ndryshimet që përcaktojnë këto periudha në krahasim me periudha të mëparshme apo në krahasim nga njëra-tjetra.

l. **ITA 255 Hyrje në gjuhësi:** Kursi i këtij semestri paraqet bazat e analizës gjuhësore: Cfarë gjuhëtarët thonë për tingujt e gjuhëve, si dhe strukturën e fjalive dhe fjalëve individuale. Studentët do të prezantohen me parimet gjuhësore dhe do të kuptojnë më shumë për mënyrën se si funksionojnë gjuhët si dhe studimin e kuptimit gjuhësor në komunikim njerëzor.

m. **ITA 260 Kulturë italiane:** Kursi *Kulturë dhe qytetërim italian* ka për qëllim të njohi studentët me zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe qytetërimit të vendeve italofone ndër vite.

Ky kurs është i konceptuar në:

1. Kultura e Italisë përgjatë shekujve dhe zhvillimet e shekullit të 21.
- b. Historia dhe gjurmët kulturore
- c. Shoqëria bashkëkohore dhe vlerat
- d. Zakonet dhe traditat
- e. Familja
- f. Qeverisja
- g. Edukimi
- h. Media
- i. Arti
- j. Sporti
- k. Besimi

n. **ITA 342 Studime të komunikimit në gjuhën italiane** është një kurs i projektuar për studentët e gjuhës italiane që të zhvillojnë njohuritë e mëtejshme dhe të kuptojnë teorinë e komunikimit nderaktiv. Ky kurs shqyrton koncepte teorike në kontekste relevante të studimit të komunikimit human. Përveç teorisë gërshetohen dhe studimet e rastit në praktikë në formën e vizitave, workshope, pjesmarrje në konferenca apo leksione të hapura në universitete të ndryshme në Shqipëri si dhe takime me organizata joqeveritare, për të krijuar njohuri me të qarta për faktorë dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

medie të ndryshme komunikimi. Në fund të semestrit studentët do të kenë përmbushur objektivat e mëposhtme: Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të:

- a. përvetësojnë kompetencat e komunikimit ndërkulturor.
 - b. ndërveprojnë me sukses në situata të ndryshme me interlokutorë që u përkasin sfoneve të tjera e të ndryshme kulturore e gjuhësore.
 - c. mendojnë në mënyrë kritike për situata të ndryshme kulturore e të gjykojnë sesi do të vepronin në rast përplasjesh kulturore.
 - d. krijojnë një sens qytetarie globale.
 - e. dallojnë stilet dhe mënyrat e ndryshme të komunikimit në një kontekst ndërkulturor.
- o. ITA 358 Sociolinguistikë e gjuhës italiane:** Në këtë kurs, sociolinguistika mësohet si një degë e gjuhësisë që studion gjuhën në raport me shoqërinë. Objektivi kryesor i sociolinguistikës është të shpjegojë se si variacionet linguistike të folësve (p.sh. sjelljet e tyre të ndryshueshme gjuhësore) janë të lidhura me variacionin në karakteristikat sociale të folësve (dmth prejardhja e tyre sociale). Qëllimi i studimit të sociolinguistikës është për të arritur një përparim të mëtejshëm në njohjen e natyrës dhe funksionin e gjuhës njerëzore nga ana e studimit të gjuhës në kontekstin e saj social. Variant i saj është rezultat i faktorëve të ndryshëm si: feja, mosha, përkatësia etnike, gjinia, etj. Ajo tregon se kombinimi i këtyre komponentëve mbart ndikim në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës.
- p. ITA 332 Gjuhësi teksti për gjuhën italiane:** Kursi *Gjuhësi teksti* është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen teori dhe metodologji për studimin e diskursit njerëzor, ose gjuhës në përdorim. Historiku i diskursit, supozimet dhe parimet, komunikimi verbal dhe joverbal, si dhe roli i shoqërisë dhe kulturës do të merren në shqyrtim. Do të diskutohet si diskursi i folur, ashtu edhe ai i shkruar.
- q. ITA 376 (ITA 376-1, ITA 372-2) Teknika të përkthimit për gjuhën italiane:** Ky kurs do të prezantojë një numër çështjesh që duhen marrë në konsideratë kur kryejmë përkthimin nga njëra gjuhë në tjetrën.(përkthimi ndërgjuhësor). Ai do të trajtojë çfarë pritet nga një përkthim i mirë dhe do të vazhdojë debatin e vazhdueshëm se sa i lirë apo besnik ndaj origjinalit duhet të jetë përkthimi në gjuhën e synuar. Ky kurs do të trajtojë tipet e teksteve, lexuesin, qëllimin dhe çështjet kulturore në përkthim. Ai do të mbështetet në teorinë e gjuhësisë moderne për të trajtuar koncepte si p.sh ekuivalenca, qoftë në nivelin e fjalës apo përtej saj, kompesimin, probleme që lidhen me përkthimin e regjistrave të gjuhës, sociolektin dhe dialektin. Leksionet dhe pjesët për lexim do t'i drejtojnë studentët tek çështjet teorike, ndërsa seminarët do të fokusohen në analizën dhe përkthimin e teksteve nga italishtja në shqip dhe anasjelltas. Kjo do t'i ndihmojë studentët për zhvillimin e aftësive të tyre në identifikimin e problemeve dhe vlerësimin e zgjidhjeve, duke u mbështetur në teorinë dhe teknikat e përkthimit, si dhe do t'i inkurajojnë ata për t'i përdorur këto aftësi në praktikë. Në të njëjtën kohë, duke analizuar dhe përkthyer tekste të ndryshme studentët do të kenë rastin të zhvillojnë dhe praktikojnë edhe kritikën e përkthimit, redaktimin dhe vlerësimin e teksteve të botuara të zhanreve të ndryshme.
- r. ITA 265 Histori e gjuhës italiane:** Kursi i Historisë së gjuhës synon t'u prezantojë studentëve etapat kryesore të zhvillimit të gjuhës italiane nga fillesat e saj me latinishten klasike deri në ditët e sotme nëpërmjet një përjasje të së kaluarës me të tashmen. Gjatë këtij kursi do të trajtohen ndryshimet dhe zhvillimet e gjuhës italiane në rrjedhën e kohës, nëpërmjet një panoramë të plotë të italishtes së viteve '200, '300, '400 për të mbërritur deri tek '900-a. Gjatë leksioneve do të flitet edhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

për debatet e famshme mbi gjuhën si dhe rëndësinë e tyre në zhvillimet e italishtes së sotme duke paraqitur shkurtimisht jetën letrare, kulturore e politike të cdo periudhe që do të merret në shqyrtim.

s. **ITA 256 Linguistikë e aplikuar për gjuhën italiane:** Kursi "*Linguistikë e aplikuar*" është një kurs hyrës, i cili synon t'i pajisë studentët që ndjekin këtë program studimi me njohuri të përmbledhura rreth bazave teorike të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës, të kuptuarit të gjuhës si sistem, në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të marrin njohuri të vlefshme rreth kësaj fushe tejet përfshirëse, por edhe t'i kuptojnë dhe zbatojnë këto njohuri gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky kurs synon që studentët:

- të kenë rritur të kuptuarit e gjuhës si sistem, duke përfshirë fonologjinë, morfologjinë, sintaksën, semantikën dhe pragmatikën.
- të jenë në gjendje t'i zbatojnë këto njohuri në mbështetje të përvetësimit të shprehive gjuhësore të dëgjimit, shkrimit, leximit, të folurit.
- të tregojnë njohje të komponentëve të shkrimit e leximit, si dhe të zbatojnë teorinë e zhvillimit të tyre tek nxënësit e gjuhës së huaj.
- të dallojnë midis zhvillimit të shkrimit e leximit në gjuhën e parë dhe në gjuhën e dytë dhe se si këto ndikojnë tek njëra-tjetra.
- të kuptojnë variablat sociokulturore, socio-politike dhe psikologjike që ndikojnë në përvetësimin e gjuhës së huaj.

t. **ITA264 Stilistikë:** Gjatë këtij kursi studentët do të njihen me konceptet bazë të Stilistikës dhe zhvillimet e rëndësishme kërkimore në këtë fushë. Kjo lëndë ofron një paraqitje të metodave dhe teorive stilistikore që ndihmojnë në zbulimin e shtresave, modeleve dhe niveleve që përbëjnë përshkrimin stilistikor për lloje të ndryshme tekstesh. Elementi i stilit dhe analizat stilistikore do të shqyrtohen të lidhura ngushtë me nivele të ndryshme të gjuhës si: nivelin fonetik, gramatikor, sintaksor, semantik dhe pragmatik. Studentët do të diskutojnë, analizojnë dhe do të vendosin në praktikë metodat dhe modelet e analizës së tekstit. Ata do të jenë në gjendje të gjejnë shenjuesit stilistikorë të tekstit letrar, ligjor, politik, gazetaresk si dhe reklamave.

u. **CS 100 Shkenca kompjuterike:** Temat e trajtuara në lëndën "Shkenca kompjuterike" sigurojnë një formim të përgjithshëm për bazat e informatikës. Në temat e trajtuara theksohet rëndësia e kompjuterit dhe informatikës në aspektin praktik. Studimi i pjeseve kompjuterike, i programeve bazë të paketës Microsoft Office, sistemet numerike, interneti, sherben për të njohur në vija të përgjithshme bazat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Kjo lëndë i njeh studentët me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si një element i domosdoshëm për funksionimin dhe suksesin e një institucioni në një shoqëri të drejtuar nga teknologjia. Studentet do të pajisen me njohuritë baze në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, duke përfituar kompetenca në përpunimin e dokumenteve, përpunimin e tabelave në excel, zhvillim dhe përdorim i bazave të të dhënave, faqosje dhe prezantim i informacionit.

v. **ENG 131 (131-1; 131-2) Anglisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- a. zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- b. përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- c. gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- d. respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- e. forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- f. thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

w. **FRE 131 (131-1; 131-2) Frëngjisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- a. zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- b. përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- c. gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- d. respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- e. forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- f. thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.
- x. Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

y. **SPA 131 (131-1; 131-2) Spanjisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- a. zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- b. përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- c. gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- d. respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- e. forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- f. thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

z. **GER 131 (131-1; 131-2) Gjermanisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit A1, A2.

aa. **ENG 132 (132-1; 132-2) Anglisht:** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit B2.

bb. **FRE 132 (132-2; 132-2) Frëngjisht:** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF B2 sipas Kuadrin të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

